

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Mr./aq/Br./str. 94
Data/Datum 22.05.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO-POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e katërt IV-të, e rregullt e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 30.04.2018, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Shaban Ademi, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Naser Graiçevci, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Arjana Zogiani, Mehdi Lahu, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Driton Ademi, Betim Ahmeti, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Qerim Gara, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Mungon: Doruntina Jashari.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Islam Shabani - Drejtor i Arsimit, Afrim Krasniqi - Drejtor i Inspektoratit, Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e OSBE-së.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e datës 30.03.2018.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Shqyrtimi i dytë i Propozimit për vazhdimin e lirimit nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore për subjektet afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018.
4. Propozim për dhënien në shfrytëzim të një pjese të objektit në Shtëpinë e Kulturës.
5. Propozim për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete.
6. Propozim për marrjen e vendimit për zgjedhjen e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete.
7. Propozim për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik.
8. Propozim për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit.
9. Propozim për themelimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
10. Propozim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
11. Propozim për themelimin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim.
12. Propozim për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra.

13. Propozim për themelimin e Komitetit për Ndërmjetësim.
14. Propozim për fillimin e bashkëpunimit për realizimin e investimeve për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës.
15. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës kërkoj nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që të deklarojnë për rendin e ditës së propozuar me pikat shtesë: 'Propozimin për fillimin e bashkëpunimit për realizimin e investimeve për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës' dhe 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e marrëveshjes për kompensimin e patundshmërisë me pronarin Adem Gjata'.

Shaban Ademi: Përshtesë të pranishmit në mbledhje. E kam të vështirë, por dua ta ndajë një informacion dhe të sqarohem me juve. Ju e dini se unë kam qenë në listën zgjedhore të Lidhjes Demokratike të Kosovës në zgjedhjet e kaluara lokale, për këtë çështje kam pasur biseda me strukturat e kësaj partie politike, të cilën e kam përkrahur edhe kur nuk kam qenë anëtar i saj në Kuvendin e Komunës në dy dekadat e fundit. Gjatë fushatës jam injoruar, nuk jam mirëpritur mirë aty, por kam heshtur! Me Kryetarin e Komunës dhe Kryetarin e partisë tuaj jam marrë vesh që unë ta kem numrin pesë, kjo ka qenë marrëveshja. Pas zgjedhjeve ndihem edhe i injoruar edhe i fyer, kam pasur takim me Kryetarin e Komunës në zyrën e tij dhe me Kryetarin e Degës së Partisë, shqetësimet e mia, padyshim, se janë të mëdha. Unë nuk kam asgjë kundër juve znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, kur jeni propozuar ju kam përkrahur me votë në Kuvendin e Komunës, nuk jam konsultuar as për zgjedhjen e Shefit të Grupit Parlamentar, fare nga askush! Prej sot unë deklaroj kandidatin i pavarur në Kuvendin e Komunës dhe do të jem i lirë ta jap kontributin tim, aq sa di dhe aq sa mundem, kjo nuk do të thotë se në të ardhmen nuk do t'i bashkëngjitem dikujt tjetër. Kam pasur takim edhe me juve, anëtarët e Grupit Parlamentar të LDK-së, ju falënderoj për bashkëpunim dhe ju respektoj çdo njërin prej juve, problemin unë e kam me Ekzekutivin e Komunës - Kryetarin e Komunës dhe Kryetarin e partisë tuaj.

Ali Ismaili: Përshtesë të pranishmit në mbledhje. Unë nuk po e kuptoj guximin që të hyjnë në rendin e ditës tjera çështje, vetëm dy minuta para mbledhjes, kur rendi i ditës veç është i stërngarkuar. Ne nuk mund t'i shqyrtojmë dy pika të reja të rendit të ditës, me material voluminoz, pa patur kohë as që t'i lexojmë dhe analizojmë fare! Kërkoj që të ndërpritet kjo praktikë e keqe dhe t'i përmbaheni 'Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018', të cilin vetë e keni miratuar.

Mehdi Lahu: Përshtesë të pranishmit në mbledhje. Edhe unë jam kundër që këto dy shkresa të reja, kështu shpejt e shpejt, të jenë pjesë e rendit të ditës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Sqaroj se 'Propozimi për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e Marrëveshjes për kompensimin e patundshmërisë me pronarin Adem Gjata', lidhur me investimet e realizuara publike në Rrugën 'Naser Sekiraga' në Fushë-Kosovë, është shtyrë për mbledhjen e muajit maj 2018.

Mehdi Lahu: Atëherë, pas sqarimeve të dhëna, unë tërhiqem nga propozimi im.

Durim Hajra: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Vërejtja e Lëvizjes Vetëvendosje është e njëjtë, kërkojmë që të bëhet publikimi i audioincizimeve. Në fjalimin tim ka mospërputhje sepse për Zyrën e Kryetarit të Komunës unë kam thënë: 'se shpenzimet janë të paarsyeshme dhe janë të larta', e jo ashtu siç është thënë në ekstraktin e procesverbalit, kërkoj që kjo të korrigjohet!

Ali Ismaili: Në faqen nëntë të ekstraktit të procesverbalit e kam një vërejtje, po e lexoj, unë këtu kam kërkuar raportin financiar të kthyer për Organizatën Joqeveritare të KARITAS-it, të cilin ne nuk e kemi marrë, sa është numri i punëtorëve në arsim, administratë dhe fusha tjera, cilat janë implikimet buxhetore dhe në faqen e trembëdhjetë, unë kam thënë që 'për Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova', pas sqarimit të problemeve në Kuvendin e Komunës, ne t'i ndajmë vetëm 20,000.00€', kjo fjali nuk është në ekstraktin e procesverbalit!

Remzi Shala: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Ne e pranojmë që ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar është i punuar mirë dhe përfshin përmbajtjen e diskutimeve tona, por kërkojmë që të bëhet një korrigjim teknik tek diskutimi im, në Shërbimin e Stomatologjisë nuk bëhet ngjitja e dhëmbëve, por pacientët trajtohen dhe u jepen këshillimet e nevojshme profesionale.

Aida Alimi: Ne jemi kundër aprovimit të ekstrakteve të procesverbaleve, përderisa nuk realizohet publikimi i audioincizimeve! Qëndrimin tonë e kemi paraqitur edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa. Ajo që u çek nga ish/Kryetari ynë është e pavërtetë dhe nuk qëndron, sepse PDK-ja është parti e vlerave dhe unë jam krenare që jam pjesë e saj.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve, pranimi dhe përfshirjes së vërejtjeve dhe sugjerimeve, në ekstraktin e procesverbalit, e qes në votim për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 30.03.2018, me përmirësime.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej (23) njëzet e tre anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës, me shumicë të votave, e aprovuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 30.03.2018, me përmirësime.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ju ftoj juve, anëtarëve të Kuvendit të Komunës, që t'i parashtroni pyetjet tuaja, ndërsa Ekzekutivin e Komunës të ofrojë përgjigje.

Mehdi Lahu: Unë e kam një pyetje dhe kërkoj sqarim për shpenzimet e varrimit që bëhen nga buxheti i komunës, në shumë prej 165€ dhe Këshilli i Bashkësisë Islame, në shumë prej 170€, ku totali i shpenzimeve është shumë i lartë dhe arrin shumën prej 335€, kjo është e paarsyeshme! Komuna e Lipjanit i ndan vetëm 115€ për një ceremoni të varrimit, në Komunën e Prishtinës ekziston çmimorja, unë kam dyshime të mëdha sa i përket këtyre çmimeve! Në Prishtinë çmimi për shërbime të njëjta: është 50€, te ne 65€, në Prishtinë 30€, te ne 50€, në Prishtinë 20€, te ne 50€! Nëse nuk reduktohen këto çmime, ne kërkojmë që kjo marrëveshje të anulohet, apo Komuna jonë i mbulon dy herë shpenzimet e varrimit, kjo është e padrejtë dhe nuk duhet të lejohet! Edhe

për projektin e punësimit me KARITAS-in neve na mungojnë raportet e punës dhe numri i të punësuarve!

Shaban Ademi: Pyetja e parë është e karakterit teknik, në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës është marrë një vendim për vizitë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Shqipëri, nuk shkohet në Shqipëri për vizitë qejfi! Ne çdo herë e kemi marrë një ftesë nga Ministria e Arsimit, unë e kam marrë atë. Kërkesa ime është që këto mjete financiare të shpenzohen për inventarizim, sepse kushtet e punës i kemi sikur në vitin 1948 menjëherë pas luftës, për një objekt të ri të komunës, kjo është fyese! Pyetja e dytë, në oborrin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi', parkingu duhet të lirohet, sepse pacientët kanë problem që të marrin shërbimet shëndetësore, tani fluksi i automjeteve është shumë i madh në oborrin e objektit shëndetësor, kërkoj që kjo hyrja te komuna të mbyllet. Ndërtimi i objektit të komunës këtu ka qenë gabim! Kjo hapësirë ka mundur të shfrytëzohet për ndërtimin e spitalit të qytetit, i cili po rritet! Objekti i komunës ka mundur të ndërtohet tek Shtëpia e Kulturës e cila është dashur të rrënohet, sepse aty janë bërë tortura të tmerrshme edhe gjatë luftës, unë kam qenë vetë aty pas luftës, kam pastruar edhe gjak. Për projektin e punësimit me KARITAS-in nuk ka patur konkurs publik! Unë pajtohem që të pranohen punëtorë në arsim dhe shëndetësi, për të cilën është i dedikuar ky projekt, por jo edhe në administratë, ku kërkohen reforma në administratë edhe nga Bashkimi Evropian, ku secila komunë parashihet t'i ketë nga 55 punëtorë dhe për çdo 750 banorë një punëtorë shtesë, ne e kemi 157 punëtorë! Deri në muajin qershor kërkohet të bëhet reforma e administratës, atëherë cila është logjika e sistemimit të punëtorëve të punësuar me projekt në Administratën e Komunës? E kam një pyetje edhe për Drejtorinë e Planifikimit Urban, në bazë të cilit dokumentacion është duke u punuar në lagjen e Graiçevcve, sepse Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka vlerësuar vendimin tonë si të jashtëligjshëm?! Ne nuk e kemi marrë pëlqimin për lejimin e ndërtimit në atë lagje, përkundrazi kemi kërkuar që të anulohet ky vendim.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është një kaos urbanistik sa i përket ndërtimeve të jashtëligjshme! Në livadhet e Bresjes, që janë tokë pjellore, është duke u bërë një ndërtim në kundërshtim me Planin Rregullues! Tokat bujqësore duhet të ruhen, sepse aty ka edhe vërshime, ne duhet t'i qasemi me kujdes zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal.

Ilir Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, hyrja te pishat, në fshatin Sllatinë e Madhe, ulëset në park mungojnë, aty nuk ka as kontejner dhe mbeturinat janë shpërndarë në hapësirë, kërkoj që të merren masa për përmirësimin e gjendjes atje, sepse kjo është edhe kërkesë e banorëve të fshatit tonë!

Betim Ahmeti: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje, a ka mundësi dhe a pritët të rregullohet çështja e ujit të pijshëm? Dje, për 24 orë me radhë, nuk ka patur ujë në lagjen 17 Shkurti dhe kjo paraqet problem për qytetarët! Pyes, gypi prej 2.5 kilometrash, që ka qenë edhe premtim edhe i fushatës zgjedhore nga Kryetari i Komunës, a do të lidhet, në mënyrë që qyteti të ketë ujë të pijshëm? Në kohën bashkëkohore njerëzit tentojnë të bëjnë zgjidhje me hidrofor, kjo nuk është në rregull! E dyta, unë e kam propozuar udhëtimin në Shqipëri ashtu siç keni shkuar edhe në mandatet e kaluara, ne jemi anëtarë të rinj, i nderuar, dhe na nevojitet përvoja! Tani ne

kemi marrë edhe vendim për binjakëzim me komunat në Itali, ne prapë mund të kërkojmë që anëtarët e Kuvendit të Komunës t'i vizitojnë edhe këto komuna.

Nënkryetari i Komunës: Çështja e ujit të pijshëm është problem për një pjesë të qytetit të Fushë-Kosovës! E dini se furnizimi me ujë është përgjegjësi e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Prishtina, e cila na ka bërë neve shantazh, të mos e quaj kështu, në mënyrë që ne t'i humbim zgjedhjet si LDK në Komunën e Fushë-Kosovës. Vitin e kaluar, nga buxheti i komunës, kemi ndarë shumën prej 160,000.00€, ata është dashur t'i ndajnë 500,000.00€ dhe prej muajit dhjetor na kanë premtuar se do ta shpallin tenderin, tani jemi në prill dhe kjo nuk ka ndodhur ende! Kjo është neglizhuar për qëllime politike! Kryetari i Komunës prapë i është drejtuar me shkresa zyrtare, Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për lidhjen e gypit nga fshati Shkabaj deri në Fushë-Kosovë. Për pyetjen e z. Mehdi Lahu, dua t'ju sqaroj se ne nuk duhet të përziemi në punët e Këshillit të Bashkësisë Islame, ne e kemi marrë një vendim që t'i mbulojmë shpenzimet e varrimit, në shumë prej 165€, për të gjitha bashkësitë fetare që jetojnë në komunën tonë, çmimet janë të caktuara nga ata, ne nuk i dimë. Ne kërkojmë llogari vetëm për mjetet financiare të lejuara nga buxheti i komunës, që ndahen për familjet tona në momentet më të vështira dhe më të pikëlluara për ta.

Mehdi Lahu: Totali i shpenzimeve për një ceremoni të varrimit është i lartë, arrin shumën 335€, kërkojmë që kjo të ndryshoj në të ardhmen!

Drejtor e Administratës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne kemi hyrë në objektin e ri të komunës me inventarin e vjetër, për arsye se nuk kemi mundur t'i shpenzojmë mjetet financiare të planifikuara me buxhet. Tani për këtë objekt e kemi të planifikuar shumën prej 80,000.00€, ky hyjnë edhe 19,000.00€ për rregullimin e sallës moderne të Kuvendit të Komunës, si dhe projekti për dixhitalizimin e radhëve të palëve.

Ali Ismaili: Fillimisht dua të them se ky është organi më i lartë në Komunën e Fushë-Kosovës, ku ne i shprehim qëndrimet tona, kërkojmë llogari për mjetet financiare të shpenzuara nga KARITAS-i, Bashkësia Islame, për ndarjen e subvencioneve në arsim, shëndetësi e bujqësi, ku shpërndahen serra e motokultivatorë, ne duhet ta dimë kush janë përfituesit, ka përfitues të njëjtë të subvencioneve në bujqësi! Unë jam Imam në fshatin Miradi e Epërme, ne nuk marrim asnjë pagesë, i këndojmë duatë për të vdekurin. Në Miradi të Epërme është një person 80 vjeçar, që nuk dua t'ia përmend emrin, që kujdeset për hapjen e varrit! Në Bardhin e Madh varrin e hapin vetë nipat, ndërsa në qytet është ndryshe, ky shërbim kërkohet dhe ofrohet për qytetarë. Shumat prej 20€ apo 30€ i determinon vetë tregu, ne nuk mund të ndërhyjmë. Detyrë e jona është të jemi të drejtpërdrejtë dhe të kërkojmë llogari në Kuvendin e Komunës, raport financiar të shpenzimeve për KARITAS-in, Bashkësinë Islame, Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova' dhe Organizatat tjera joqeveritare. Ne ndajmë buxhet për projektin e punësimit me KARITAS-in për katër vite, ndërsa disa njerëz më kërkuan mua të pyes, sepse ende nuk i kanë marrë pagat, kush është menaxheri i kontratave, ai duhet të jap raport me shkrim?

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E kam një pyetje për Drejtorinë e Inspektoratit në lidhje me lokalet që janë afër stadiumit të futbollit. Aty janë katër lokale ku zhvillohen dukuri negative - prostitucioni, kjo paraqet pengesë dhe një dukje jo të mirë për banorët që jetojnë aty! Kërkoj që Drejtoria e Inspektoratit të kontrollojë këto lokale se si funksionojnë dhe

të ndërmerr masat e duhura lidhur me këtë çështje. Pyetja e dytë ka të bëjë me qentë endacakë ku ne kemi bërë bartjen e mjeteve nga viti 2017 për këtë punë. Pyes, pse nuk është hapur tenderi për eliminimin e tyre? Ju e dini se në fshatin Harilaç është një strehimore që i mbledh qentë nga e tërë Kosova dhe shpeshherë e bënë lëshimin e tyre në hapësirë, kjo paraqet një problem të madh për banorët e fshatit tonë! Pyetja e tretë ka të bëjë me Kalanë e Harilaçit, ku janë bërë investime nga Komuna dhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit por ajo hapësirë nuk mirëmbahet dhe po përdoret natën nga narkomanë të ndryshëm! Kërkoj që të vendoset një portë hyrëse aty dhe të evidentohet kush hyn dhe kush del.

Aida Alimi: Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Arsimit lidhur me regjistrimin e nxënësve në klasat e para në Shkollën 'Mihal Grameno', ku duhet të përdoren disa kritere për regjistrim të nxënësve, sepse aty po regjistrohen nxënës nga lagjet më të largëta të qytetit, e jo nga lagjet e afërta! Për këtë çështje kam informata se prindërit do të vijnë të protestojnë para komunës.

Driton Hasolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje dhe dua të parashtroj një kërkesë të banorëve të fshatit Bardh i Madh të cilët kërkojnë që të mbillen pemë sepse ndotja nga mihja sipërfaqësore është e madhe. Po ashtu kërkesë tjetër e qytetarëve është që në fshat të bëhet një park që do t'iu shërbente qytetarëve për rekreacion.

Naser Graiçevci: Kërkoj që ta mbajmë një minutë heshtje për punëtorin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi', Bedri Paci, i cili ka ndërruar jetë!

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Ftoj të pranishmit në mbledhje që ta mbajmë një minutë heshtje për punëtorin shëndetësor, të ndjerin Bedri Paci!

Drejtori i Inspektoratit: Dua të përgjigjem në lidhje me pyetjen e anëtarit të Kuvendit të Komunës, z. Migjen Kolshi, se lokalet aty punojnë me leje të punës dhe në përputhje me procedurat ligjore. Inspektorët i bëjnë kontrollet këtyre lokaleve, por juve po ju pengon sepse e keni biznesin aty. Kontrollet bëhen edhe nga inspektorët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Migjen Kolshi: Shqetësimi është i banorëve, e jo i imi personal, sepse aty vijnë njerëz të moshës tuaj për femrat që punojnë aty dhe ju nuk i keni kontrolluar ato lokale fare çfarë shërbime ofrojnë, kush është pronar, a kanë librezat sanitare punëtorët, a posedojnë arka fiskale! Pronarët e atyre lokaleve janë ndërruar disa herë dhe ju lutem që këtë çështje të mos e ktheni në personale, sepse aty zhvillohet një prostitucion i pastër, kjo punë është e dukshme.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me pyetjen e parashtuar nga anëtari i Kuvendit, z. Ilir Hasani, pajtohem se lokacioni 'Te pishat' është mjaft i frekuentuar nga njerëzit dhe aty momentalisht ka disa defekte por ne do të ndajmë një pjesë të buxhetit për rregullimin e asaj hapësire. Po ashtu pajtohem, keni të drejtë, se kjo hapësirë duhet të menaxhohet dhe kontrollohet më mirë, sepse po shkaktohen dëme enorme të ulëseve dhe shportave që gjenden aty. Lidhur me pyetjen e anëtarit të Kuvendit, z. Migjen Kolshi, dua të sqaroj se ne e kemi vendosur një laurë aty por është demoluar. Kohë pas kohe, aty frekuenton edhe Policia e Kosovës. Ndërsa lidhur me pyetjen e anëtarit të Kuvendit, z. Driton Hasolli, ne në vjeshtë parashohim që të mbjellim pemë dekorative dhe këtë do ta bëjmë edhe në fshatin Bardh i Madh, por ju, në koordinim me komunën, duhet të përcaktoni lokacionin ku duhet të bëhet parku.

Pika e tretë (3) - Shqyrtimi i dytë i 'Propozimit për vazhdimin e lirimit nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore për subjektet afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018'.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e dytë 'Propozimin për lirimin e bizneseve nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'. Ftoj Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik që të na jap sqarime.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Lidhur me lirimin e bizneseve nga taksa komunale ne i kemi zhvilluar procedurat e parapara me ligj, më datë 25.04.2018 kemi mbajtur diskutimin publik dhe iniciativa për lirimin e bizneseve nga taksat është mirëpritur nga subjektet afariste. Ne i kemi pëlqyer idetë dhe propozimet e juaja, të dhëna në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe e kemi formuar një grup punues për hartimin e Rregullores së re për Taksa Komunale ku do të rregullojmë edhe vendosjen e taksave për bizneset për periudhën e ardhshme afatmesme. Informatat lidhur me bizneset dhe numrin e tyre ndryshojnë, anëtar i Kuvendit, z. Naser Graiçevci, ka punuar më herët në strukturat udhëheqëse të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është njohës i mirë i këtyre çështjeve për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës. Në këtë ministri prej vitit 1999 janë regjistruar 4200 biznese, mirëpo funksionale janë 1056, prej tyre shumica janë mikrobiznese. Është edhe standard që kërkohet nga Bashkimi Evropian luftimi i informalitetit, mirëpo edhe ne si komunë i kemi obligimet tona që ta japim kontributin tonë për krijimin e kushteve për zhvillimin e bizneseve, duke iu siguruar atyre energji të mjaftueshme si dhe qasje më të lehtë në financa nëpër banka. Nga raportet financiare shihet se borxhet e bizneseve janë diku rreth 780 000 euro që janë grumbulluar me vite të tëra, ne do të shikojmë mundësinë që nëse e lejon ligji t'i falim ato.

Driton Ademi: Krijimi i kushteve për biznese, me lirimin nga taksat është një lloj likuiditeti që u bëhet votuesve për përmbushjen e hipotekave të pranura nga pushteti aktual, mirëpo kjo formë e lirimit përfshin një periudhë gjashtëmbëdhjetëvjeçare të menaxhimit jo të duhur me bizneset. A është analizuar pjesa e të hyrave vetjake që do të jenë më të vogla për përmbushjen e nevojave për investime për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës? Qëllimi tjetër duhet të jetë që komuna të ofrojë shërbime cilësore në raport me zhvillimin e bizneseve në territorin e komunës.

Naser Graiçevci: Për çështjen e lirimit të bizneseve nga taksat ne e kemi dhënë qëndrimin tonë se duhet t'i bashkëngjitemi komunave tjera përreth. Bizneset që operojnë në komunën tonë janë mikrobiznese që vështirë funksionojnë dhe duhet të përkrahen, bizneset nga fusha e ndërtimit bazën e tyre e kanë në Prishtinë. Aspekti i të bërit biznes në Komunën e Fushë-Kosovës përmban në vete fluksin e madh të njerëzve të ardhur, zakonisht hapen kafene ku jetëgjatësia e tyre është tre deri në gjashtë muaj, këto biznese nuk mund të qëndrojnë në treg dhe investimet e bëra me mijëra euro i humbin. Ne kërkojmë që bizneseve të qëndrueshme t'iu vendosim taksa të larta deri në 200 euro sepse kjo e garanton kualitetin në punë dhe mbijetesën e biznesit, bujqit që e punojnë tokën e mbetur djerrinë, pra bizneset prodhuese të lirohen nga taksat. Ndërsa bizneset që zhvillojnë bixhoz, bastoreve të ndryshme t'iu rriten taksat në mënyrë që ato t'i dekurajojmë në zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Kërkesë tjetër e jona është edhe që bizneset që ofrojnë shërbime t'i kenë taksat e ulëta.

Durim Hajra: Edhe ne jemi që të krijohen lehtësira për zhvillimin e biznesit por jo pa kritere të qëndrueshme. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik a ka bërë analiza për ndërhyrjen dhe efektet për lirimin nga taksat në vitin e kaluar? Ne jemi që të favorizohen bizneset e jo të lirohen plotësisht

nga taksat. Duhet të përkrahen në mënyrë të specifikuar bizneset prodhuese dhe bizneset që regjistrojnë numrin e punëtorëve. Po ashtu kërkojmë që ta bëjmë një ndarje reale të bizneseve sepse dallon fuqia ekonomike dhe mundësia e operimit në treg e një hipermarketi dhe një dyqani të vogël. Ne si Lëvizje Vetëvendosje nuk jemi për këtë formë të lirimit të bizneseve nga taksat por kërkojmë që të bëhet ndarja dhe kategorizimi i tyre.

Ali Ismaili: Mua më pëlqeu fjalimi i anëtarit të Kuvendit, z. Naser Graicevci, i cili e përmbledhi një diskutim të thukët lidhur me këtë çështje. Në katër faqe të 'Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale' listohen të gjitha bizneset, pa ndonjë kategorizim, të gjitha futen në një thes të përbashkët dhe kërkohet pezullimi i nenit 8! Me pezullimin e këtij neni komplet bizneset: bastoret, automatet e ndryshme, lokalet e mbyllura favorizohen dhe në këtë mënyrë ne po bëjmë gabim sepse po legalizojmë dhe stimulojmë 'haramin'. Ministria e Financave ka nxjerrë një Udhëzim përmes të cilit kërkon që distanca e këtyre objekteve - bastoreve të jetë larg objekteve shkollore. Këto biznese edhe me 600 euro pagesë, sa është e caktuar me Rregullore, mbijetojnë pa asnjë problem. Ne pajtohemi që të lirohen nga taksat e biznesit fermerët që zhvillojnë veprimtari prodhuese dhe dyqanet e vogla zejtare. E falënderoj Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik që kësaj radhe na ka dhënë sqarime të plota për strukturën e bizneseve që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre afariste në territorin e komunës. Tabela e bizneseve në faqen 4, 5 dhe 6 të Rregullores është e papërpunuar, ne duhet ta bëjmë një diferencim se a po vazhdojmë me shfuqizimin e nenit 8 apo me pezullimin e tij të përkohshëm për periudhën njëvjeçare.

Nënkryetari i Komunës: Mendoj se ju i dhatë sugjerimet tuaja profesionale lidhur me këtë temë, fushatën e lirimit të bizneseve nga taksat e ka nisur PDK-ja, ndërsa ne do ta pezullojmë zbatimin e nenit 8 edhe për vitin 2018, kurse e kemi formuar një grup punues i cili do të bëjë hartimin e Rregullores së re e cila do të hyjë në fuqi për vitin 2019, aty do ta bëjmë ndarjen e bizneseve ku do t'i marrim në shqyrtim opinionet e juaja dhe do të vendosim së bashku për taksat që do t'i vendosim për lojërat e fatit dhe bizneset tjera.

Ali Ismaili: Unë kërkoj sqarime sepse dua që të jem i bindur për atë që duhet të vendosë kur e jap votën time, se a është ai vendim i ligjshëm apo jo! Ne me vendimet tona nuk po ndikojmë në përmirësimin e gjendjes ekzistuese! Ju e keni shumicën dhe mund të vendosni, por do të ishte mirë që kjo pikë të shtyhet dhe të caktojme vendosjen e taksave për biznese ashtu siç duhet e jo t'i përkrahim lojërat e fatit! Përveç Kuvendit unë do të përdor edhe mediat, rrjetet sociale, 'facebook-un', sepse në këtë mënyrë, siç po doni të veproni ju si shumicë, nuk përmirësohet gjendja!

Nënkryetari i Komunës: Sqaroj se ne si komunë nga taksat e biznesit i grumbullojmë 150,000.00€, për neve si pozitë kjo është e mirë. Ndarja dhe seleksionimi i bizneseve do të bëhet me Rregulloren e re.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik: Propozimi i anëtarit të Kuvendit të Komunës, z. Ali Ismaili, është i arsyeshëm, duhet ta bëjmë regjistrimin e bizneseve sipas natyrës së tyre. Edhe Ministria e Financave ka aprovuar 'Pakon fiskale 1' dhe 'Pakon fiskale 2', që i ndihmon bizneset, jo me mjete financiare, por me pajisje, edhe ne duhet të bëjmë plane afatmesme për përkrahjen e bizneseve. Ju ftoj që ta aprovi propozimin në fjalë për vitin 2018. Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për vazhdimin e lirimit nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore për subjektet afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018'.

U votua me: dhjetë vota 'për', gjashtë 'kundër' dhe pesë abstenime, gjithsej (21) njëzet e një anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për vazhdimin e lirimit nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore për subjektet afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018' dhe bëri këtë:

Ndryshimin e 'Rregullores Komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 63, të datës 16.05.2013' duke e vazhduar shfuqizimin e nenit 8 edhe për vitin kalendarik 2018 dhe shfuqizon ndryshimit e Rregullores Nr. 03, të datës 10.01.2017.

Pika e katërt (4) - Propozim për dhënien në shfrytëzim të një pjese të objektit në Shtëpinë e Kulturës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndarjen e hapësirës në objektin e Shtëpisë së Kulturës për Shoqatën e Viktimave Civile dhe Invalidëve të Luftës'. Hap diskutimin.

Shaban Ademi: Objekti i Shtëpisë së Kulturës është simbol i së keqes dhe urrejtjes patologjike ndaj shqiptarëve. Aty është mbajtur fjalimi çetnik i diktatorit Slllobodan Millosheviç në vitin 1989 si dhe ka pasur shtypje dhe dhunim të shqiptarëve në vitin 1999. Kjo është një arsye më shumë që të zbatohet vendimi i Kuvendit të Komunës për rrënimin e këtij objekti që është simbol i së keqes dhe një objekt i demoluar. Unë kam qenë Drejtor i parë i Shtëpisë së Kulturës, aty ka pasur shenja të terrorit nga pushteti i okupues serb dhe me rimorkio janë hequr rroba të brendshme të femrave. Kërkoj që vendimet e marra nga Kuvendi në mandatin e kaluar të zbatohen, jo vetëm ky vendim, por edhe 'Vendimi për shndërrimin e objektit shëndetësor në fshatin Henc në 'Shtëpi pritëse' për banorët e fshatit.

Aida Alimi: Edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa e kam dhënë qëndrimin tonë, ndonëse ne nuk jemi kundër kësaj shoqate, mirëpo propozimi nuk është i detajuar sa duhet, në mënyrë që ne të vendosim! Unë e kam një kërkesë tjetër, që të aktivizohet teatri në komunën tonë.

Ali Ismaili: Është bërë traditë që në Kuvendin e Komunës të kemi kërkesa me nga dy rreshta në të cilat nuk thuhet asgjë, p.sh.: në kërkesën në fjalë nuk ka asnjë sqarim për aktivitetin e kësaj shoqate, numrin e anëtarëve të saj, por vetëm thuhet se shoqata do ta përdorë objektin për rrobaqepësi. Kërkoj nga Nënkryetari i Komunës që të gjendet një zgjidhje për neve si përfaqësues të subjekteve politike, të na ndahet një hapësirë ku mund të takohemi me qytetarët për shqyrtimin e problemeve të tyre, në atë objekt, apo të merret ndonjë objekt me qira. Për këtë shoqatë thuhet se i ka marrë donacion makinat e qepjes por nuk specifikohet sa persona do ta zhvillojnë aktivitetin aty!

Nënkryetari i Komunës: Është e vërtetë që ne e kemi marrë një vendim për rrënimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës, por për ekzekutimin e tij nevojitet që ta kemi një projekt të detajuar për ndërtimin e objektit të ri, ku do t'u bëhej zgjidhje shoqatave të kulturës, sportit, subjekteve politike dhe organizatave tjera joqeveritare. Përfaqësuesit e kësaj shoqate nuk kanë shprehur interesim që t'i shfrytëzojnë objektet tona publike në fshatrat: Bardh i Madh dhe Miradi e Poshtme por kanë kërkuar ndarjen e një hapësire në qytet për zhvillimin e veprimtarisë së tyre, është detyrë e juaja si Kuvend i Komunës që të vendosni lidhur me këtë çështje.

Remzi Shala: Ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa e kemi përkrahur këtë propozim dhe kemi shprehur vullnetin tonë që kësaj shoqate, ku bëjnë pjesë një kategori e

ndjeshme e shoqërisë sonë, t'i ndihmojmë dhe t'ua japim një mundësi, pa paragjykitime për aspektet tjera procedurale dhe administrative. E vetmja gjë që kemi kërkuar është kufizimi kohor i shfrytëzimit të hapësirës. Ne duhet ta shfrytëzojmë këtë objekt dhe t'ua japim një mundësi këtyre grave deri në momentin kur vendoset të rrenohet objekti në fjalë.

Migjen Kolshi: Unë nuk dua të paragjykoj, sa i përket kësaj shoqate, por ne duhet ta dimë se si do të zhvillohen aktivitetet e saj, si dhe a do t'i zhvillojë aktivitetet në përputhje me legjislacionin, andaj propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjet tjera.

Mehdi Lahu: Ne duhet t'i kemi disa sqarime lidhur me planin e punës së kësaj shoqate për rrobaqepësi dhe të mos keqpërdorim në fjalimet tona biznesin privat i cili ende nuk e ka filluar aktivitetin.

Betim Ahmeti: Kërkoj nga Nënkryetari i Komunës që të mos thirret si përfaqësues i LDK-së dhe i pozitës, sepse këtu është për t'i mbrojtur interesat e gjithë qytetarëve, pa dallim. Kjo organizatë nuk e ka valide as certifikatën për operim si shoqatë, asaj i ka skaduar afati në vitin 2015, selinë e ka në Prishtinë e jo në Fushë-Kosovë, dokumentacionin e ka të paplotësuar në aspektin administrativ! Andaj, kërkoj që kjo pikë të shtyhet për shqyrtim në mbledhje tjera.

Driton Ademi: Kuvendi i Komunës nuk duhet të merrë vendime të jashtëligjshme dhe ju rikujtoj se Nënkryetari i Komunës këtu përfaqëson institucionin, e jo partinë! U tha nga ai se: 'neve na konvenon të mbledhim taksat', por lirimi nga taksat është një premtim që i është bërë votuesve para fushatës zgjedhore! Po ashtu kërkojmë që të kujdeseni që për shqyrtim në Kuvendin e Komunës të mos na dërgohen materiale të pakompletuara, këtë dukuri janë të thirrur ta verifikojnë vetë shërbyesit civil me rastin e pranimit të lëndëve.

Shaban Ademi: Duhet të dihet cila veprimtari është e ligjshme dhe cila e paligjshme. Z. Migjen Kolshi biznesin e vet e ka të ligjshëm, ndërsa nuk ka nevojë që të kamuflohet asgjë sepse dihet që në ato lokale zhvillohet prostitucioni. Është detyrë e inspektorëve komunalë dhe të nivelit qendror që t'i mbyllin këto lokale. Këto lokale mund ta kenë të ligjshëm dokumentacionin por zhvillimin e veprimtarisë e bëjnë të jashtëligjshëm dhe kjo është e keqja kryesore në rastin konkret.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve e qiti në votim Propozimin për shtyrjen e kësaj pike për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme për të cilin propozim u pajtuan në mënyrë unanime anëtarët e Kuvendit të Komunës, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë.

Koha e pushimit 15 minuta.

Pika e pestë (5) - Propozimi për emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete.
Kjo pikë është tërhequr nga rendi i ditës në fillim të mbledhjes.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për caktimin dhe zgjedhjen e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete'.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për caktimin dhe zgjedhjen e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete'. Kjo pozitë sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i takon përfaqësuesit të Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës z. Qerim Gara, i cili ka fituar më së shumti vota në listën e hapur të Zgjedhjeve Lokale të 22 tetorit. Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për zgjedhjen e z. Qerim Gara në pozitën e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete'. U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej (20) njëzet anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për zgjedhjen e z. Qerim Gara në pozitën e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete' dhe mori:

V E N D I M

Për zgjedhjen e z. Qerim Gara në pozitën e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2017/2021.

Pika e shtatë (7) - Propozim për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi prapë në shqyrtim 'Themelimin e Komiteteve tjera Këshillëdhënëse', të cilat duhet të themelohen në përputhje me dispozitat e 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera' duke respektuar kriterin gjinor dhe caktimin e anëtarëve profesionist për secilin komitet. Hap diskutimin.

Ali Ismaili: Partia e Drejtësisë nuk pajtohet me mënyrën e themelimit të Komitetit për Politikë e Financa sepse ai është bërë jo në formë të drejtësisë dhe rregullave por sipas vullnetit të shumicës në Kuvendin e Komunës. E njëjta formë e gabueshme po tentohet të imponohet edhe për themelimin e Komiteteve tjera Këshillëdhënëse. Ne si tri subjekte politike kemi kërkuar interpretim nga niveli qendror për mënyrën e themelimit të Komitetit për Politikë e Financa dhe këtë interpretim ende nuk e kemi marrë, edhe pse kanë kaluar disa muaj! Komiteti për Politikë e Financa është dashur të themelohet sipas rregullave nga shtatë subjektet e para politike, të tjerët kemi mundur të përfaqësohemi në Komitetin për Komunitete, nëse partia në pushtet do të lejonte hapësirë për arritjen e një marrëveshje të përbashkët për përfaqësim në Komitetet e Përhershme.

Aida Alimi: Ne jemi në proces të zgjedhjeve të brendshme në Partinë Demokratike të Kosovës, andaj propozoj që pikat e rendit të ditës të shtyhen për miratim në mbledhjen e ardhshme.

Remzi Shala: Forma e përfaqësimit është e përcaktuar me 'Rregulloren për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera' ku LDK i ka tre përfaqësues, PDK një përfaqësues, LVV një përfaqësues, subjektet tjera politike nga një përfaqësues dhe komunitetet nga një përfaqësues. Grupi Parlamentar i LDK-së i ka emrat për përfaqësim në këto komitete tjera, por meqë partitë tjera nga opozita nuk i kanë emrat, pajtohem që këto pika të rendit të ditës të shtyhen për aprovim në mbledhjen e ardhshme.

Ali Ismaili: Dua të sqaroj se 'Nisma', AAK-ja dhe Partia e Drejtësisë nuk do t'i japin emrat e vet, përderisa nuk marrim përgjigje nga niveli qendror për kërkesën tonë!

Nënkryetari i Komunës: Për Komitetin për Politikë e Financa është kthyer përgjigje se themelimi i tij është i ligjshëm. Këtu kemi të bëjmë me një mandat katërvjeçar dhe partitë politike që përfaqësohen në Kuvendin e Komunës me nga një anëtar të arrijnë marrëveshje për përfaqësimin e tyre në Komitetet tjera.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Sqaroj para anëtarëve të Kuvendit se lidhur me këtë çështje do ta kemi një takim të përbashkët me përfaqësuesit e subjekteve politike, të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, deri më datë 10 maj, dhe pas dorëzimit të emrave nga subjektet politike këto pika do t'i vendosim sërish në rendin e ditës.

Pas këtyre sqarimeve anëtarët e Kuvendit të Komunës u pajtuan unanimisht që 7 pikat për themelimin e Komiteteve tjera Këshillëdhënëse të shtyhen për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme.

Pika e katërmëdhjetë (14) - Propozim për fillimin e bashkëpunimit për realizimin e investimeve për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim kërkesën e Kompanisë Polake 'Green Tec Solution' për investime në riciklimin e mbeturinave të llojeve të ndryshme, ku pritet të punësohen 150 punëtorë. Ftoj përfaqësuesin e Ekzekutivit të Komunës që të na jap sqarime shtesë.

Nënkryetari i Komunës: Prona që kërkohej nga investitori i jashtëm Kompania Polake 'Green Tec Solution' është pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, më herët kjo pronë ka qenë e ushtrisë por me një vendim të Qeverisë është kthyer në pronë shtetërore. Ne kërkojmë që Kuvendi i Komunës t'ia dërgojë një shkresë zyrtare Qeverisë për marrjen në shfrytëzim të kësaj prone për zhvillimin e biznesit nga kjo kompani e jashtme, e interesuar për investime në Fushë-Kosovë.

Mehdi Lahu: Këtu thuhet se ne duhet ta dërgojmë një kërkesë fillestare në Qeverinë e Kosovës, mirëpo ende nuk është bërë studimi i fizibilitetit për zhvillimet e këtij biznesi. Ne jemi që të ketë investime të jashtme por duke ndjekur hapat e nevojshëm për realizimin e tyre.

Mirvete Gërguri: Kjo kërkesë është bërë me vonesë, ky investitor synon që të bëjë grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave të llojeve të ndryshme - lëndëve djegëse, por nuk ka asnjë parametër se si do të mbrohet mjedisi! Ne i dimë dëmet që na janë shkaktuar nga termocentralet tona. Më mirë do të ishte që të punohet për realizimin e investimeve për furnizim me ujë të pijshëm për banorët e komunës tonë.

Naser Graiçevci: Lidhur me investimet ne kemi përvoja të këqija, sepse jemi në një mjedis ku ndotja është e madhe, pasi që afër nesh gjenden termocentralet dhe deponia e mbeturinave në Mirash. Për investime në zonën e Sllatinës së Madhe dhe te Parku Industrial, ka pasur edhe të interesuar tjerë nga Italia, mirëpo kemi frikë se ndikimi afatgjatë në mjedis do të jetë i dëmshëm! Pa marrë parasysh se kompanitë e mëdha sot përdorin teknologjinë e fundit për riciklimin e mbeturinave, detyrë e jona është që të kujdesemi jo vetëm për investime por edhe për mjedisin, ky është mendimi im si anëtar i Kuvendit të Komunës.

Driton Ademi: Unë pajtohem me mendimin e anëtares së Kuvendit të Komunës z. Mirvete Gërguri, sepse edhe përkundër ekzistimit të teknologjisë së zhvilluar sot, ndriçimi solar ka dështuar në Komunën e Fushë-Kosovës. Zona e fshatit Harilaç duhet të përdoret për zhvillimin e turizmit.

Betim Ahmeti: Tek Shkolla 'Mihal Grameno' është krijuar një grumbull i mbeturinave të cilat ndjellin qentë endacakë e që paraqesin rrezik për banorët në atë zonë! Andaj, kërkoj që të ndërmerren veprimet e duhura nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Nënkryetari i Komunës: Ne e kemi një kërkesë për investime të drejtpërdrejta në Komunën e Fushë-Kosovës. Kompania e jashtme Green Tec Solution ka kërkuar hapësirën prej 20 hektarëve, ndërsa kjo pronë e qeverisë i ka vetëm 8 hektarë. Pajtohem se duhet të kemi kujdes për mbrojtjen e mjedisit.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Çështja e pronës prej 8 hektarëve në zonën e Harilaçit nuk duhet të përdoret për investime sepse njerëzit i kanë vendimet që ajo pronë është e tyre dhe u është marrë qytetarëve tanë para 45 viteve për nevoja të ushtrisë. Kjo pronë është pronë individuale e shqiptarëve dhe ekzekutivi i komunës nuk duhet të na vendosë neve para dilemave me një proces të vendimmarrjes i cili nuk është i drejtë! Po ashtu në atë zonë parashihet të ndërtohet nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit 'Stadiumi Kombëtar i Futbollit'.

Nënkryetari i Komunës: Sipas dokumentacionit kjo pronë i takon Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe dokumentacioni është i verifikueshëm nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës. Ne i dimë edhe shpronësimet që janë bërë nga Korporata Energjetike e Kosovës, njerëzit i punojnë tokat atje por nuk janë pronar.

Sabit Bullatovci: Ju duhet ta dini se nga viti 1983 e deri në vitin 2018 nuk kemi shënime për asgjë lidhur me ndërrimin e pronarëve në të kaluarën. Ato prona u janë marrë shqiptarëve. Qeverisja duhet të jetë profesionale, e jo Kadastri dhe Gjeodezia të udhëhiqen nga një Kimist i diplomuar siç është z. Jakup Tërrnava! Ne nuk duhet të shqyrtojmë dokumentacion 'ad hoc'. Zona atje përbëhet nga 500 hektarë male me drejtim të Komunës së Drenasit dhe atje është i koncentruar zhvillimi i industrisë, po ashtu banorëve për shpronësimin e pronave për rregullimin e shtratit të lumit 'Sitnicë' është tentuar t'iu ndahet prona fushore në fshatin tim, ndërsa më vonë ata janë kompensuar me pronë në fshatin Miradi e Epërme.

Ali Ismaili: Kjo kërkesë në parim nuk është e sinqertë! Nga dokumentacioni shihet se ka pasur një takim të përfaqësuesit të kësaj kompanie me Kryetarin e Komunës si dhe që do të ketë një investim prej rreth 4 milionë euro, por nuk ka të dhëna tjera që e garantojnë realizimin e këtij investimi!

Migjen Kolshi: Ajo që e tha anëtari i Kuvendit, z. Sabit Bullatovci, është e vërtetë sepse pronat u janë marrë gjyshërve tanë në mënyrë të dhunshme nga pushteti i atëhershëm. Propozimi për miratim na dërgohet në momentin e fundit, dhe unë dhe z. Ali Zogiani, që jemi nga fshati Harilaç, nuk dimë se a do të mbrohet mjedisi dhe a do të ketë mundësi punësimi për banorët e fshatit. Unë nuk jam pajtuar as kur është marrë vendimi për transferimin e Kompanisë Kosmonte Foods atje, andaj edhe kësaj radhe unë do të abstenojë sepse nuk kemi të dhëna të mjaftueshme se si do të zhvillohet ky biznes!

Nënkryetari i Komunës: Unë dua t'ju njoftoj se kam qenë në një takim me Kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, ku është biseduar me kryetarët e komunave për mundësinë e shfrytëzimit të tokës pyjore për realizimin e investimeve të huaja. Aty është thënë nga vetë Kryeministri se kërkesa të tilla do të përkrahen. Kërkesa ka pasur edhe për shfrytëzimin e pronës ku është i vendosur dheu nga Korporata Energjetike e Kosovës në fshatin Lismir dhe Bardh i Madh, në sipërfaqe prej 300 hektarëve. Po ashtu, edhe pyjet në fshatin Sllatinë e Madhe janë të evidentuara në emër të Kombinatit 'Tefik Çanga'. Për realizimin e këtij investimi të drejtpërdrejtë nga investitori nevojiten të merret Pëlqimi edhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Driton Ademi: Së pari, kërkesa që bëhet duhet ta ketë një qëllim të caktuar, duhet të dihet se a është prona shoqërore apo publike, dhe jo ne të vendosemi në një votim të dyshimtë ku nuk kemi sqarimet e nevojshme sepse vetë qeveria komunale është diskutabile lidhur me këtë çështje dhe realizimin e këtij investimi!

Naser Graiçevci: Kjo kërkesë sikur është pa adresë. Ne e dimë se në bazë të 'Ligjit për Investime Strategjike' kërkesa për investime është e identifikuar me emrin e kompanisë që do ta bëjë investimin.

Nënkryetari i Komunës: Ne si Komunë nuk kemi prona komunale, andaj duhet të kërkojmë marrjen në shfrytëzim të pronës nga qeveria.

Pas sqarimeve, se ne si Kuvend i Komunës do t'i drejtohem Qeverisë së Republikës së Kosovës vetëm me një kërkesë lidhur me këtë pronë, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për dërgimin e një kërkesë zyrtare nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës për marrjen në shfrytëzim të kësaj prone shtetërore'.

U votua me: dhjetë vota 'për', gjashtë 'kundër' dhe tri abstenime, gjithsej (19) nëntëmbëdhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi për dërgim dhe shqyrtim në Qeverinë e Republikës së Kosovës:

Kërkesën për marrjen në shfrytëzim të pronës shtetërore në sipërfaqe prej $S = 85274m^2$ për realizimin e investimeve për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës.


Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që ta marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 13:15 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

